

**PROCESVERBAL**

**PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E PROCEDURËS SË  
PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT “BLERJE PAJISJE LABORATORIKE PËR  
INSTITUTIN E NDËRTIMIT”**

I mbajtur sot në datë 03.09.2024 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit”, me fond limit **43,942,150** (dyzet e tre milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur.** Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, është arritur në konkluzionin se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote pasi kemi të bëjmë me një grup pajisjesh, puna e të cilave është e ndërlidhur me njëra - tjetrën, çka do të thotë se për një proces të plotë pune pranë laboratorit të Institutit të Ndërtimit, është e domosdoshme që të gjitha pajisjet/materialet të prokurohen së bashku. Pra nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit me mallrat objekt prokurimi në një procedurë të vetme.

**NJËSIA E PROKURIMIT**